



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

**NJOFTIM PËR VEND PUNE SI SPECIALIST PËR ÇËSHTJE TË TJERA  
ADMINISTRATIVE**

Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP), i krijuar në kuadër të Ligjit nr. 100 91 datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, me seli në rrugën Rr. Ismail Qemali, Ndërtesa nr. 22, Hyrja 4, Apartamenti nr. 24, Tiranë, kërkon të punësojë një “Specialist për Çështje të Tjera Administrative”.

**I. Kandidati duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:**

- Të jetë shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;
- Të ketë zotësi për të vepruar;
- Të ketë përfunduar studimet universitare të ciklit të parë në degën Financë / Juridik / Shkenca Sociale;
- Të ketë eksperiencë pune jo më pak se një vit;
- Të mos jenë marrë ndaj tij/saj masa disiplinore të largimit nga puna për shkak të një shkelje të rëndë disiplinore;
- Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë;
- Të zotërojë gjuhën Angleze në nivel të pranueshëm dhe të përshtatshëm për punën.

**II. Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë kandidati:**

- Letër motivimi;
- Dokument Identifikimi;
- Curriculum Vitae;
- Fotokopje e diplomës;
- Reference pune nga punëdhënësit e mëparshëm.

Personat e interesuar duhet të paraqesin dokumentat e sipërcituara deri në datën 31.01.2025, elektronikisht në adresën e emailit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike ([info@bmp.al](mailto:info@bmp.al)) ose pranë zyrave të Bordit të Mbikëqyrjes Publike në adresën Rr. Ismail Qemali Nd. 24, H. 4, Kati 5-të, Ap. 24, Tiranë.

Duke ju falënderuar,

Bordi i Mbikëqyrjes Publike